



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranverorë

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 50

Prishtinë, më 25.04.2024, në orën 16:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Morën pjesë: Hydajet Hyseni Kaloshi dhe Bahrim Shabani, zëvendëskryetarë, Drita Millaku, Arijeta Rexhepi, Enis Kervan, Fridon Lala dhe Bekim Arifi, anëtarë.

Munguan: Elmi Reçica, Valentina Bunjaku Rexhepi, Shemsedin Dreshaj, Adem Hoxha dhe Fadil Gashi, anëtarë.

Të pranishëm të tjerë: Celal Iliaz, përfaqësues i Drejtorisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni Kaloshi, zëvendëskryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 4.04.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjin nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave, me raport amendamente të Komisionit funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-207 për tekstet shkollorë, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsime, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 4.04.2024.

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 4.04.2024, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjin nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave, me raport amendamente të Komisionit funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim;

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave me raport amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Meqë nuk pati diskutime, zëvendëskryetari konstatoi se në bazë të rezultatit unanim, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesa e komuniteteve.
2. Raporti me amendamente të komisionit Funksional, rekomandohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-207 për tekstet shkollore, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport;

Zëvendëskryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-207 për tekstet shkollore me raport amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Enis Kervan, theksoi se gjatë shqyrtimit të Projektligjit për tekstet shkollore, në grupin punues të komisionit funksional, janë dhënë propozime në dobi të komunitetit joshumicë, siç janë:

Tekstet mësimore për lëndë të përgjithshme të komunitetit joshumicë kalojnë të njëjtën procedurë të vlerësimit, përzgjedhjes dhe botimit, sipas ligjit: tekstet e lëndëve të përgjithshme, përcaktimi i lëndëve, kriteret për përkthim dhe botim, rregullohen me akte nënligjore të Ministrisë; tekstet shkollore dhe mjetet mësimor për mësimin e gjuhës dhe kulturës së komuniteteve në diasporë e mërgatë, rregullohen me marrëveshje të Ministrisë së Arsimit, në harmoni me shtetet amë; si dhe lektyrat shkollore në gjuhën e komuniteteve joshumicë në përputhje me planin dhe programin mësimor të klasës dhe lëndës përkatëse, rregullohen në marrëveshje me Ministrinë e Arsimit. Këto propozime janë inkorporuar në raport final.

Pas diskutimeve, zëvendëskryetari konstatoi se në bazë të votimit unanim, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

3. Projektligji nr.08/L-207 për tekstet shkollore, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesa e komuniteteve.
4. Raporti me amendamente të komisionit FunkSIONAL, rekomandohet për miratim në Kuvend.

5. Të ndryshme.

Meqë nuk kishte çështje për diskutim, mbledhja përfundoi.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Hydajet Hyseni Kaloshi,

Zëvendëskryetar i Komisionit